

## Perspektivat e Eksportit për Produktet Shqiptare

*Pas kërkesës zyrtare të Shqipërisë për anëtarësim në BE në maj 2009, lëvizja e lirë e mallrave në Evropë është me rëndësi të madhe për prodhuesit shqiptarë të produkteve. Por, para se një produkt të vendoset në tregun e BE, duhet të plotësojë disa kërkesa. Informacione mbi legjislacionin aktual teknik dhe Infrastrukturën e Cilësisë, mbështetur nga raste praktike reale do të paraqiten në seminarët e mëposhtme promovionale. Këto aktivitete janë pjesë e projektit CARDS 2006 "Standardizimi, Akreditimi, dhe programi i Vlerësimit të Konformitetit në Shqipëri" i financuar nga BE.*

---

## Seminare promovuese në Shkodër, Elbasan, Vlorë.

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe me mbështetjen e projektit CARDS 2006 "Standardizimi, Akreditimi dhe Vlerësimi i Konformitetit" kanë organizimin një fushatë promovionale në 3 qytete të Shqipërisë (Shkodër, Elbasan, Vlorë).



Në aktivitetet promovionale të zhvilluara përkatësisht në Shkodër më 6 Maj, në Elbasan 27 Maj dhe në Vlorë më 15 Qershor 2010, dy Institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë DPS dhe DPA, prezantuan mënyrat se si palët e interesuara mund të marrin informacione mbi standardet, akreditimin dhe kërkesat që duhet të përmbushë një produkt para se të hyjë në tregun e BE.

Prezantimi i DPS përmbante: Rreth standardizimit në Shqipëri, Statusi i DPS-s në Organizmat Europiane dhe Ndërkombëtare të Standardizimit, Publikimet (Katalogu, Buletini, Artikuj, Broshura); ku mund të gjenden ato. Një hapësirë e veçantë ju dha faqes tonë të internetit sidomos në pjesën e Katalogut online. Të dhëna statistikore mbi adoptimet në vite, strukturën e arkivës sonë sipas standardeve, shitjet e standardeve, seritë më të shitura, çmimet e standardeve për bashkëpunëtorët, fushat prioritare, objektivat dhe sfidat për vitin 2010, etj.



Në këto aktivitete morën pjesë biznese, institucione publike apo private, laboratorë testues, organizma certifikues, inspektues, si dhe të interesuar të tjerë për procesin standardizimin apo akreditimit të cilët

### **Perspektivat e Eksportit për Produktet Shqiptare**

*Pas kërkesës zyrtare të Shqipërisë për anëtarësim në BE në maj 2009, lëvizja e lirë e mallrave në Evropë është me rëndësi të madhe për prodhuesit shqiptarë të produkteve. Por, para se një produkt të vendoset në tregun e BE, duhet të plotësojë disa kërkesa. Informacione mbi legjislacionin aktual teknik dhe Infrastrukturën e Cilësisë, mbështetur nga raste praktike reale do të paraqiten në seminarët e mëposhtme promovionale. Këto aktivitete janë pjesë e projektit CARDS 2006 "Standardizimi, Akreditim, dhe programi i Vlerësimit të Konformitetit në Shqipëri " i financuar nga BE.*

---

ndoqën prezantimet dhe bënë pyetje, sugjerime, ngritën problematika si dhe sollën shembuj të suksesshëm të bizneseve që eksportojnë jashtë Shqipërisë duke treguar rrugën që kishin ndjekur.

Qëllimi i këtij turi aktivitesh ishte rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e Standardizimit dhe procedurat e Vlerësimit të Konformitetit për eksportin e produkteve jashtë Shqipërisë.

Nëse jeni të interesuar për më tepër, na kontaktoni: Tel.: + 355 04 222 62 55 / e-mail: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al)